

V E N D I M
Nr.727, datë 19.11.1998

**PËR KRIJIMIN E KOMITETIT TË SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL PËR
AEROPORTIN**

Në mbështetje të nenit 15 të ligjit nr.8310, datë 19.3.1998 “Për sigurinë në aviacionin civil shqiptar”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijohet Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin, për zhvillimin, bashkërendimin dhe zbatimin e masave të sigurimit, të procedurave në aeroport.
2. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin përbëhet nga:

Drejtori i aeroportit	kryetar
Shefi i rajonit të policisë, Rinas	zëvendëskryetar
Shefi i imigrimit të aeroportit	anëtar
Drejtori i ANTA-së	“
Drejtori i doganës së aeroportit	“
Komandanti i regjimentit 4020 të aeroportit	“
Përgjegjësi i zjarrfikësve të aeroportit	“
Përgjegjësi i sektorit të sigurisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil	“
Përgjegjësi i sigurisë së aeroportit	“
Kryetari i bordit të kompanive ajrore, që operojnë në aeroport	“

3. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin mbledhet rregullisht çdo 2 muaj, me kërkesën e kryetarit ose në raste të veçanta, me kërkesën e çdo anëtari të këtij komiteti.

4. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin ka për detyrë:

a) të marrë masat e duhura për zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e sigurisë së aviacionit civil shqiptar;

b) të raportojë pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Aviacionit Civil për nivelin e sigurisë në aeroport, masat e marra dhe ato që duhen marrë për të arritur nivelin e kërkuar, si dhe për çdo problem që lidhet me sigurinë në aeroport e që dalin jashtë kompetencave të këtij Komiteti.

c) të programojë dhe të ndjekë planin e kualifikimeve, të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, për kualifikimin e personelit të aeroportit dhe të organizmave të tjerë, që veprojnë në të.

5. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin merr masa për të bashkërenduar zbatimin e akteve nënligjore, të dala në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe që kanë për qëllim përmirësimin e procedurave të sigurisë në aeroport.

6. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin merr masa për të zbatuar, me përpikëri, procedurat e parashikuara në planin e rasteve të jashtëzakonshme, të miratuara nga institucionet përkatëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në aeroport.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

